AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 25.9.2026

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 61/2012, "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas pikës 10, të nenit 109, "Dispozita kalimtare", të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

"11. Përjashtimisht, në rastet kur në bazë të vendimit të Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit (në vijim Bordi), i ngritur sipas ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, çmimi tavan për shitjen me pakicë për benzinën dhe gazoilin është mbi nivelet e mëposhtme:

a) 200 lekë/litri për benzinën;

b) 220 lekë/litri për gazoilin,

niveli i akcizës së këtyre produkteve zbatohet në masën 80% të niveleve të caktuara në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij ligji, si më poshtë vijon:

i. benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, niveli i akcizës është 31.50098 lekë/litri;

ii. gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, niveli i akcizës është 31.50098 lekë/litri.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 16.9.2026, dhe përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së situatës së veçantë, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu